

# Statistika të Diplomimeve


2018-2019

**Tiranë, më 15 Maj 2020:** Në vitin 2019, në arsimin 9 - vjeçar u diplomuan 34.982 nxënës, ose 96,4 % e nxënësve të klasës së nëntë të vitit shkollor 2018 - 2019, duke shënuar një rritje prej 1,0 përqindje, krahasuar me vitin paraardhës. Në këtë nivel arsimor u diplomuan 52,6 % djem dhe 47,4 % vajza.

Në vitin 2019, në arsimin e mesëm u diplomuan 34.021 nxënës, me një rënie prej 3,6 %, krahasuar me 2018. Në këtë nivel arsimor u diplomuan 47,9 % djem dhe 52,1 % vajza. Të diplomuarit e arsimit profesional përbëjnë 11,2 % e të diplomuarve gjithsej në arsimin e mesëm.

Në vitin 2019, raporti bruto i diplomimit në arsimin e mesëm, është 84,6 %.

Fig. 1 Shkalla e diplomimit në arsimin e mesëm




## Të Diplomuar në arsimin e lartë

Në vitin 2019 janë diplomuar në arsimin e lartë 34.891 studentë, ose 1,6 % më shumë se në vitin 2018. Ndër të diplomuarit e këtij viti, 66,4 % janë gra dhe 33,6 % janë burra. Të diplomuarit në programet Bachelor përbëjnë 53,6 % të studentëve të diplomuar gjithsej. Fusha në të cilën janë diplomuar më shumë studentë në të gjitha programet është "Biznes, administrim dhe ligj" prej 27,8 %.

Për publikim 15/05/2020


Fig. 2 Të Diplomuar në arsimin e lartë sipas fushës së studimit, 2019



Në vitin 2019, gratë dhe burrat e diplomuar sipas fushave të studimit, mbajnë përqindje të ndryshme ndër të diplomuarit gjithsej. Fushat në të cilat janë diplomuar më shumë gratë janë “Arsim” me 81,4 % ,ndjekur nga “Shëndet dhe mirëqenie” me 79,1 % dhe “Arte dhe shkencë humane” me 78,2 %. Fushat në të cilat janë diplomuar më shumë burrat janë “Shërbime” me 73,6 %, “Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim” me 62,6 % , dhe “Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinar” me 55,1 %.

Fig. 3 Të Diplomuar në arsimin e lartë sipas fushës së studimit dhe gjinisë, 2019

%



# Metodologjia

Arsimi në Shqipëri është i organizuar sipas këtyre programeve dhe klasifikuar sipas Klasifikimit ISCED-2011 që përdoret ndërkombëtarisht në statistikat e arsimit :

Niveli 0 - Arsimi parashkollor – çerdhe / kopshte

Niveli 1 - Arsimi fillor ose cikli i ulët i arsimit bazë

Niveli 2 - Arsimi i mesëm i ulët ose cikli i lartë i arsimit bazë

Niveli 3 - Arsimi i mesëm i lartë - Gjimnaz / Profesional / Social kulturor

Niveli 4 - Arsimi pas të mesmes por jo i lartë

Niveli 5 - Arsimi i lartë cikël i shkurtër

Niveli 6 - Bachelor ose ekuivalent

Niveli 7 - Master ose ekuivalent

Niveli 8 - Doktoraturë ose ekuivalent

## Përkufizime:

**Arsimi parauniversitar** përfshin arsimin që kryhet nga institucionet arsimore si: kopshte, shkolla 9 vjeçare dhe të mesme.

**Arsimi 9 vjeçar** ose arsimi bazë, përbëhet nga dy cikle: cikli i ulët ose arsimi fillor, i cili kryhet në klasat 1 - 5 dhe cikli i lartë ose arsimi i mesëm i ulët, i cili kryhet në klasat 6 - 9. Arsimi 9 vjeçar është i detyruar, fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Nxënësi ka detyrimin të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç.

**Arsimi i mesëm** përfshin gjimnazin, arsimin profesional, cili ndahet në të ulët teknik dhe të lartë, si edhe atë social – kulturor. Ky i fundit paraqitet në statistika bashkë me arsimin profesional.

**Arsimi profesional** përfshin programet e arsimit të dizajnuara me qëllime përfitimin e njohurive, shkathtësitë dhe kompetencat specifike për një profesion të veçantë, klasë të profesioneve ose tregti.

**I diplomuar** në një program arsimor është një nxënës ose student, i cili ka përfunduar në mënyrë të suksesshme të gjitha kërkesat e programit.

**Raporti bruto i diplomimit** është numri i të diplomuarve pavarësisht moshës në një nivel ose program.

Burimi i të dhënave të diplomimeve : MASR dhe MFE.